



Prishtinë, 14 tetor 2020
Kodi i ZRRE-së: V_1297_2020

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,

Bazuar në:

- Dispozitat e nenit 26 paragrafi 1, nenit 47 dhe nenit 48 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë Nr. 05/L-084;
- Dispozitat e nenit 19 të Ligjit për Energjinë Nr. 05/L-081;
- Dispozitat e nenit 18 dhe nenit 19 të Ligjit për Energjinë Termike Nr. 05/L-052;
- Rregullën për Vendosjen e Çmimeve të Energjisë Termike; dhe
- Kërkesën e Ndërmarrjes Publike - Ngrohtorja e Qytetit (NQ) Termokos sh.a. të datës 12 gusht 2020, për shqyrtimin e të Hyrave maksimale të lejuara dhe tarifave të energjisë termike, bashkë me dokumentacionin relevant sqarues.

Pas shqyrtimit të shkresave dhe dokumenteve relevante, duke u bazuar në dispozitat ligjore të cekura më lartë, në seancën e mbajtur me datë **14 tetor 2020**, nxori këtë:

VENDIM

- I. APROVOHEN TË HYRAT MAKSIMALE TË LEJUARA (MAR)** në vlerën **6,960,802 €** për NQ Termokos sh.a. që do të mbledhen nga tarifat e energjisë termike (ngrohjes) për konsumatorët fundorë për sezonin 2020/2021;

Arsyetim

- Me datë 12 gusht 2020 Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) ka pranuar kërkesën nga NQ Termokos sh. a. për shqyrtimin e të Hyrave Maksimale të Lejuara që ndërmarrjes i lejohet të mbledhë nga tarifat e energjisë termike për konsumatorët fundorë.
- Për përcaktimin e të Hyrave Maksimale të Lejuara, ZRRE ka marrë parasysh dokumentet dhe shkresat si në vijim:
 - Të dhënat dhe informatat e dorëzuara bashkangjitur me kërkesën për shqyrtimin e të Hyrave Maksimale të Lejuara, të datës 12 gusht 2020;
 - Komentet me shkrim lëshuar nga ZRRE me 28 gusht 2020, ku janë specifikuar kërkesat për korrigjim, përmirësim dhe plotësim të të dhënave dhe informatave të dorëzuara bashkangjitur me kërkesën e datës 12 gusht 2020;
 - Të dhënat dhe informatat e korrigjuara dhe të plotësuara sipas komenteve me shkrim të ZRRE-së, ri-dorëzuar nga NQ Termokos me datë 04 shtator 2020;
 - Raportin për Konsultim Publik: Vlerësimet Preliminare për Përcaktimin e të Hyrave Maksimale të Lejuara për NQ Termokos – sezoni i ngrohjes 2020/2021;



- Komentet me shkrim të pranuar gjatë periudhës së konsultimit publik (21 shtator – 05 tetor 2020);
 - Përgjigjen e ZRRE-së ndaj komenteve me shkrim të pranuar gjatë periudhës së konsultimit publik;
 - Raportin Final për Përcaktimin e të Hyrave Maksimale të Lejuara për NQ Termokos – sezoni i ngrohjes 2020/2021.
3. Duke marr parasysh dispozitat ligjore të cekura në hyrje dhe duke u bazuar në shqyrtimin e të gjitha shkresave dhe dokumenteve relevante, Bordi ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.
- II. Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) ka të drejtë, që të auditojë regjistrat e kontabilitetit dhe faturat e NQ Termokos për të verifikuar realizimin e të dhënave të paraqitura nga NQ Termokos.
- III. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes midis versioneve, do të mbizotërojë versioni në gjuhën shqipe.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i ZRRE-së dhe do të zbatohet nga NQ Termokos nga data 15 tetor 2020 gjer në shqyrtimin e ardhshëm tarifor;
- V. Ky Vendim publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Këshillë juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të inicioj konflikt administrativ në gjykatën kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve, nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të Vendimit në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

Bordi i ZRRE-së,

Arsim Janova, u.d. Kryesues

Besim Beftaj, anëtar

Selman Hoti, anëtar

Izet Rushiti, anëtar

Bashkangjitur: Raporti Rregullativ: Përcaktimi i të Hyrave të Lejuara për NP Termokos sh.a. – sezoni i ngrohjes 2020/2021

Vendimi ju dërgohet:

- Palës; dhe
- Arkivit të ZRRE-së